



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit**

Data/Datum/Date:	13.09.2022
Nr./Br./No	02/517
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës Shtime – z.Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	PROPOZIM-VENDIM

**Propozim-Vendim për Ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Npi – 01/60, datë: 28.03.2022
për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes.**

Kuvendit të Komunës së Shtimes i propozoj ndryshimin e pikës 3 të Vendimit të Kuvendit Npi – 01/60, datë: 28.03.2022 për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes, në të cilin, si përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, është zgjedhur z.Milaim Musliu, të zëvendësohet me Togerin z.Gzim Morina.

Arsyetim: Duke u bazuar në shkresën e z.Xhevahir Hasanaj – Kapiten i kompanisë për operacione me civilë e datës 19.04.2022 kemi marrë konfirmimin se “Përfaqësues për KKSb-në në Komunën e Shtimes caktohet Togeri Gzim Morina.

Po ashtu propozoj që Kuvendi i Komunës të plotësoj pikën 9 të vendimit me emrin e z.Bajram Ilazi i cili është zgjedhur Kryesues i Komitetit për Komunitete me vendimin Npi – 01/86 datë: 27.04.2022.

Re: Kërkes për caktimin e një përfaqësuesi të FSK-së në KKSB - Shtime

Xhevahir Hasanaj <Xhevahir.Hasanaj@fsk-rks.org>

Tue 4/19/2022 1:17 PM

To:

Cc:

• You

- Gzim MORINA;
- QOTKOC

I nderuar zotëri Rexhepi,

Përfaqësues për KKSB në komunën tuaj caktohet Toger Gzim Morina.

gzim.morina@fsk-rks.org

049903433

Kisha kërkuar nga ju nëse është mundësia që në ftesat për mbledhje të KKSB të futet në CC edhe qendra operative e njësisë me qëllim që në rast se Toger Morina nuk mund të jetë prezent të caktohet dikush tjetër për pjesëmarrje.

Emaili zyrtar i Qendrës Operative: gotkoc@fsk-rks.org

Me respekt,

Xhevahir Hasanaj

Kapiten, Kompania për Operacione me Civilë - KOC

phone: + 383 49 902 740 / + 383 44 198 597

address: Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë

email: xhevahir.hasanaj@fsk-rks.org / xh.hasanaj@gmail.com

From: Idajet Rexhepi <i.rexhepi@hotmail.com>

Sent: Tuesday, April 19, 2022 2:32 PM

To: Xhevahir Hasanaj

Subject: Kërkes për caktimin e një përfaqësuesi të FSK-së në KKSB - Shtime

KUJDES! : Ky email vjen nga jashtë FSK. Mos klikoni në linqe ose të hapni dokumentet e bashkangjitura në këtë email, përveç nëse e njihni dërguesin dhe e dini që përmbajtja është e sigurt.

Përshëndetje, i nderuar z.Xhevahir Hasani.

Bashkëngjitur ua dërgova një kopje të vendimit për ta pas më të qartë gjithë situatën.

Kuvendi i Komunës së Shtimes më 28.03.2022, ka miratuar Vendimin për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes, ku si përfaqësues i FSK-së është zgjedhur z.Milaim Musliu.

Në komunikim me Milaim Musliun më ka njoftuar se nuk mund të merr pjesë në takimet e KKSB-së për shkak se është i caktuar në detyra të tjera.

Me këtë rast po kërkoj nga ju që të na njoftoni se kush mund të jetë përfaqësues i FSK-së në mbledhjet e KKSB në Komunën e Shtimes.

Ju lutem na dërgoni Emrin e Mbiemrin dhe të dhënat e tijë, për qëllim të komunikimit më të lehtë.

Ju urojmë punë të mbarë.

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME

Idajet Rexhepi

Bashkëpunëtor Profesional i Kuvendit

Mob: +383(0)44 592 430

Nr. zyr: +381(0)290389016 lokali-107

E-mail: i.rexhepi@hotmail.com

E-mail zyrtar: idalet.rexhepi@rks-gov.net

Rr.“TahirSinani” Nr.50 - 72000 Shtime

Orari i punës 8 – 16 h

II Save paper...think before you print !



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01/060/01-5020/22 datë: 21.02.2022



Npi – 01/60 datë:28.03.2022

Bazuar në nenin 58 pikat (g, h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 7 të Ligjit për Policinë e Kosovës Nr.04/L-076, si dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB dhe U.A-03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Kuvendi i Komunës së Shtimes në vazhdimin e dytë të mbledhjes së dytë të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 28.03.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

I

Kuvendi i Komunës së Shtime në vazhdimin e dytë të mbledhjes së dytë të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më datën: 28.03.2022, unanimisht miratoi Vendimin për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes, në përbërjen si vijon:

1. Qemajl Aliu..... Kryetar i Komunës,
2. Fatmir Limani.....Komandant i Policisë – Shtime,
3. Milaim MusliuPërfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës,
4. Skender BaftiuKryetar i KBI, dhe Imam i Xhamisë - Shtime,
5. Skender DautiPërgjegjës i Zyrës për Mbrojtje dhe Shpëtim,
6. Ibrahim DemiriUdhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
7. Lulzim SahitiDrejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim,
8. Reshat Gashi Kordinator për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore,
9. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
10. Shefki Osmani Përfaqësues i Komitetit Ashkalinjë,
11. Arton Demiri Përfaqësues i Komitetit Rom,
12. Basri Hyseni Përfaqësues i Prindërve në shkollat e komunës së Shtimes,
13. Zhaneta Demiri Përfaqësuese e OJQ – "Vizionida" Shtime,
14. Muhadin Halili Përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
15. Albert Ramadani Përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike.

II


Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Shfuqizohet, Vendimi i mëparshëm i Kuvendit të Komunës së Shtimes 01Nr.006/6476-61, i datës 19.03.2014, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

IV


Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim,



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-10309/22, datë:22.04.2022



Npi – 01/86 datë: 27.04.2022

Duke u bazuar në nenin 51.1 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Neneve 34 dhe 40 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 dt. 03.09.2008; Neneve 9 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë; Si dhe duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës për formimin e Komitetit për Komunitete, Npi – 01/55 datë:28.03.2022, Komiteti për Komunitete në mbledhjen e mbajtur më: 27.04.2022 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

I

Komiteti për Komunitete në mbledhjen e parë, për vitin 2022, e mbajtur më: 27.04.2022, unanimitisht, zgjedhi z.Bajram Ilazin - Gjyrkovc, Kryesues i Komitetit për Komunitete, përfaqësues nga komuniteti Ashkali.

II


Mandati i Kryesuesit, Zëvendës-Kryesuesit dhe anëtarëve tjerë të Komitetit për Komunitete, përfundon me përfundimin e mandatit të Kuvendit të Komunës.

III

A r s y e t i m: z.Bajram Ilazi – Gjyrkovc, i rekomanduar nga OJQ-ë “Zëri i Romëve, Ashkalinjëve, dhe Egjiptianëve” që të jetë përfaqësues i komunitetit Ashkali në Komitetin për Komunitete. z.Bajram Ilazi, është zgjedhur unanimitisht, Kryesues i Komitetit për Komunitete, pranë Kuvendit të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Kryetarit, Kryesuesit të Kuvendit, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi